

Erasmus+

për arsimin e lartë
dhe studentët



Erasmus+

**Ndryshim jetësh,
çlirim i mendjeve**

With the support of the Erasmus+ of the European Union

Reproduction is authorised provided the source is acknowledged

PËRMBAJTJA

Çështje Erasmus +?	4
Zyra Kombëtare Erasmus+	7
Ku mund të aplikojë Shqipëria në Erasmus+ ?	8

PJESA I

Ku aplikojnë institucionet shqiptare në Erasmus+?

- Çështje kodit PIC?.....	9
- KA1 Shkëmbimet afatshkurtra për stafet dhe studentët (<i>International Credit Mobility</i>).....	11
- KA 2 Projektet “Rritja e kapaciteteve në arsimin e Lartë (CBHE)” ose ish-Tempus.....	12
- Programi Jean Monnet	18
- Programet e tjera në KA2 (Aleancat për njohuri, Aleancat në fushën e Aftësive, Partneritetet strategjike në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë)	20

PJESA 2

Ku aplikojnë individët shqiptarë (studentë, pedagogë, staf administrativ) në Erasmus+?

- KA 1 “Shkëmbimet afatshkurtra për stafet dhe Studentët” (<i>International Credit Mobility</i>).....	23
- KA 1 Shkëmbimet për Mastera dhe Doktorata të përbashkëta (<i>Degree Mobility</i>) në Erasmus Mundus dhe Erasmus+;.....	25
- Aplikimet individuale për shkëmbimet afatshkurtra në Partneritetet Erasmus Mundus.....	27
- KA 2 Komponenti i mobiliteteve në kuadër të projekteve “Rritja e kapaciteteve në arsimin e lartë”	34
KEY ACTION 3 “Mbështetja për reformat arsimore”	35
Rinia dhe Sporti.....	37
Fjalorth	38

PËRMBAJTJA

Ç'është Erasmus +?

Erasmus+ është një program i Bashkimit Evropian (BE) që mbështet financiarisht një sërë veprimtarish në fushat e Arsimit, Trajnimit, Rinisë dhe Sportit për periudhën 2014-2020. Erasmus + ngrihet mbi përvojën dhe suksesin e programeve të mëparshme arsimore të BE-së (Tempus, Erasmus Mundus, Alfa, Edulink, etj) dhe mbështet shkëmbimet ndërkombëtare të studentëve, stafeve akademike dhe administrative, qarkullimin e praktikave më të mira midis institucioneve të arsimit të lartë dhe forcimin e lidhjeve midis arsimit dhe tregut të punës. Programi është përgatitur nga Komisioni Evropian i BE-së dhe zbatohet nga Agjencia Ekzekutive për Arsimin, Mediat dhe Kulturën (EACEA), në Bruksel, Agjencitë Kombëtare (NA) të ngritura në secilin Vend Programi dhe Zyrat Kombëtare Erasmus në Vendet Partnere si Shqipëria.

Erasmus + është i rëndësishëm për Shqipërinë pasi ai do të mundësojë dhe financojë shkëmbime të shumta studentësh dhe stafesh akademike dhe administrative, si dhe bursa për Master të përbashkët në universitetet më të mira në Vendet e Programit. Gjithashtu, Erasmus + do të mbështesë bashkëpunimin midis institucioneve të arsimit të lartë shqiptare dhe atyre evropiane, për të zhvilluar qasje të reja në mësimdhënie, harmonizimin e programeve, kualifikimin e vazhduar të stafeve, bashkëpunimin me ndërmarrjet private e aktorë të tjerë, me qëllim lehtësimin e transferimit të dijeve, përshtatjen me nevojat e tregut të punës, etj.





Zyra Kombëtare Erasmus+

Zyra kombëtare Erasmus+ drejtohet nga koordinatorja kombëtare dhe funksion në mënyrë autonome, duke përfaqësuar interesat e Komisionit Evropian. Ajo përbën një qendër reference për të gjithë aktorët e arsimit të lartë, aplikantët, përfituesit dhe të gjithë të interesuarit e tjerë në lidhje me aktivitetet e Erasmus+ në fushën e arsimit të lartë. Zyra Erasmus+ luan një rol të rëndësishëm në promovimin dhe këshillimin për aplikime në Erasmus+, jep asistencë teknike për përgatitjen e projekteve, gjetjen e partnerëve dhe aspekte të tjera kyçe për projekte të suksesshme. Gjithashtu, ajo është përgjegjëse për monitorimin e projekteve që zbatohen në institucionet shqiptare.

Zyra Kombëtare Erasmus+ ndodhet në Tiranë, tek Pallati i Kulturës, në katin e tretë. Mund ta kontaktoni në:

Tel: +355 4 2256508

Fax: +355 4 2240435

Email albania@erasmusplus.al


Ku mund të aplikojë Shqipëria

Mundësia e përfshirjes së Shqipërisë (si vend Partner) në aktivitetet e Erasmus + paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Komponenti i ERASMUS+	Mundësia e përfshirjes
KA 1 Diplomë Masteri të Përbashkët ** (Joint Master Degrees)	Po
KA 1 Shkëmbimet për Kredite ** (Credit Mobility)	Po
KA 2 Rritja e Kapaciteteve në Arsimin e Lartë* (Capacity building in Higher Education)	Po
Mundësia për komponentin e mobilitetit	Po
KA 2 Aleanca e Njohurive, Aleanca e Sektorit të Aftësive** (Knowledge alliances, sector skills alliances)	Pjesërisht
KA 2 Partneritetet Strategjike në Arsim, Trajnim dhe Rini** (Strategic partnerships in education, training and youth)	Pjesërisht
Jean Monnet*	Po
KA 1 Projektet e Mobilitetit Rinor ** (Youth Mobility Projects)	Po
KA 2 Rritja e Kapaciteteve në fushën e rinisë (Capacity building in the youth field)	Financimi mund të jetë i disponueshëm në një fazë të mëvonshme
KA 3 Dialogu i Strukturuar Rinor** (Structured dialogue youth)	Po
Partneritetet e Bashkëpunimit në Sport** (Sport Collaborative Partnerships)	Pjesërisht

*Shqipëria mund të përfshihet në rolin e partnerit dhe aplikantit/ ** Mund të përfshihet vetëm në rolin e partnerit

 Përfshirja e mundshme vetëm nëse sjell një vlerë të shtuar

 Buxheti i disponueshëm pavarësisht programimit IPA

Pjesa I

KU APLIKOJNË INSTITUCIONET SHQIPTARE NË ERASMUS+?

Ç'është kodi PIC?

Çdo institucion që aplikon në Erasmus + duhet të ketë kodin PIC (Participant Identification Code). Çdo IAL ka një kod unik, i cili krijohet dhe administrohet nga një përfaqësues i caktuar nga Rektori përkatës. Asnjë institucion nuk mund të përfitojë nga fondet Erasmus+ pa validuar statusin e kodit PIC. Kodet PIC me status “declared” “sleeping” mund të pranohen në aplikim me kusht që të validohen në rast se projekti shpallet fitues. Për të ditur kodin PIC të validuar të institucionit tuaj, mjafton të vizitoni linkun në vijim. <http://ec.europa.eu/education/participants/portal/desktop/en/organisations/search.html>





Foto © Copyright: Universiteti Epoka

KEY ACTION 1 (KA1) “NXITJA E SHKËMBIMEVE PËR INDIVIDËT”

10

Institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri aplikojnë në Erasmus + VETËM në aktivitetet e mëposhtme.

KA1 SHKËMBIMET AFATSHKURTRA PËR STAFET DHE STUDENTËT (INTERNATIONAL CREDIT MOBILITY)

Universitetet shqiptare lidhin marrëveshje dypalëshe me universitete nga Vendet e Programit (vendet e BE-së plus Turqia, Islanda, Liechtensteini, Norvegjia dhe FYROM). Këto marrëveshje përfshijnë shkëmbime studentësh dhe stafesh, të cilat mbulohen financiarisht nga fondet Erasmus+. Kohëzgjatja e shkëmbimeve për studentët do të jetë nga 3-12 muaj, për stafet akademike dhe administrative 5 ditë deri në 2 muaj.

Si aplikon një universitet?

Hapi i parë: Aplikimi është vetëm institucional dhe jo individual. Universiteti shqiptar zgjedh universitetin partner me të cilin do të kryejë shkëmbimet, në një nga Vendet e Programit.

Hapi i dytë: Së pari, shprehet interesi për të marrë pjesë në projektet e “*International Credit Mobility*”. Në rast se universiteti i zgjedhur bie dakord në parim, negociohen shkëmbimet: numri i studentëve dhe i stafit, njohja e periudhës së studimit, niveli gjuhësor i kërkuar etj. Negociohet midis dy universiteteve marrëveshja ndër-institucionale, e cila do të nënshkruhet nga rektorët përkatës ose nga përfaqësuesit e tyre ligjorë. Për universitetet që nuk kanë programe në gjuhë të huaj, shkëmbimet e studentëve mund të kërkohen nga universiteti shqiptar në drejtim të universitetit të zgjedhur. Shkëmbimet e stafit mund të jenë në të dy drejtimet për qëllime mësimdhënieje ose trajnimi.

Modeli i marrëveshjes ndër-institucionale ndodhet në linkun në vijim http://ec.europa.eu/education/opportunities/higher-education/doc/partner-programme-iaa_en.pdf

Hapi i tretë: Universiteti nga vendi i programit (jo ai shqiptar) plotëson formularin e aplikimit në emër të universiteteve partnere që ka zgjedhur dhe e dorëzon atë pranë Agjencisë Kombëtare në vendin e tij. Nëse projekti midis dy universiteteve përzgjidhet fitues, studentët, pedagogët dhe stafi administrativ mund të aplikojnë për shkëmbime.

11

USER EXPERIENCE IN INTERACTIVE MULTIMEDIA APPLICATIONS



dr. Matevž Pogačnik
dr. Jože Guna
University of Ljubljana, Slovenia

Belgrade, September 2014

© Laboratory for Telecommunications, Faculty of Electrical Engineering



KA 2 PROJEKTET "RRITJA E KAPACITETEVE NË ARSIMIN E LARTË (CBHE)" OSE ISH-TEMPUS

Projektet për 'Rritjen e kapaciteteve' janë pasardhësit e projekteve Tempus. Të gjitha Institucionet e Arsimit të Lartë, publike dhe private, të njohura nga shteti mund të aplikojnë në projektet për 'Rritjen e kapaciteteve' si aplikant (koordinator) ose si partner. Krahas universiteteve, edhe agjencitë,

OJF-të që veprojnë në fushën e arsimit, bizneset, dhomat e tregtisë, etj mund të aplikojnë si partnerë në CBHE. Kohëzgjatja projekteve varion nga 24 deri në 36 muaj dhe vlera e financimit grant nga 500.000 në 1 milion Euro. Zyra Kombëtare Erasmus+ është zyra përgjegjëse për promovimin e projekteve CBHE, për mbarëvajtjen e zbatimit dhe monitorimin e tyre.

Për çfarë shërbejnë projektet për 'Rritjen e kapaciteteve'?

Nëpërmjet projekteve për 'Rritjen e kapaciteteve', universitetet shqiptare mund të modernizojnë metodat e mësimdhënies, të krijojnë programe të reja studimi ose të përmirësojnë programet ekzistuese

duke i harmonizuar me ato të vendeve të zhvilluara të BE-së, të trajnojnë stafet akademike, të përmirësojnë laboratorët, të krijojnë ose të përmirësojnë shërbimet për studentët, për sigurimin e brendshëm të cilësisë, etj.



Sa është numri minimal i universiteteve partnere në një projekt CBHE?

Projektet për ‘Rritjen e kapaciteteve’ kërkojnë bashkëpunimin e disa universiteteve si vijon:

-një projekt kombëtar, kërkon bashkëpunimin e të paktën 6 universiteteve: tre nga Shqipëria dhe tre nga tre vende të ndryshme të Programit (psh, një nga Franca, një nga Greqia, një nga Gjermania);

-një projekt *multi-country*, kërkon bashkëpunimin e të paktën 7 universiteteve: dy nga Shqipëria, dy nga një vend tjetër partner (psh. Serbia) dhe një nga tre vende të ndryshme të Programit (psh, një nga Finlanda, një nga Norvegjia dhe një nga Italia).

Bizneset, shoqatat, OJF-të, agjencitë që veprojnë në fushën e arsimit nuk llogariten në numrin minimal të partnerëve të kërkuar, por mund të shtohen në konsorciumin e ngritur nga universitetet, nëse ndihmojnë për përmbushjen e objektivave të projektit.

14



Foto © Copyright: Universiteti Epoka

Cilat janë llojet e projekteve?

Projektet CBHE ndahen në: Projekte të përbashkëta (*Joint projects*) që synojnë të ndikojnë në nivel institucioni dhe Projekte Strukturore (*Structural projects*) që synojnë të ndikojnë në politikat dhe reformat e arsimit të lartë. Ministria e Arsimit dhe Sportit është partner i detyrueshëm në Projektet strukturore.

Ç’është komponenti i shkëmbimeve?

Ndryshe nga programi Tempus, projektet për “Rritjen e kapaciteteve” mundësojnë, në rastin e Shqipërisë, një komponent shkëmbimesh për studentët dhe stafet (për studentët 3-12 muaj, praktika 2-12 muaj, për stafin akademik dhe administrativ 5 ditë deri në 2 muaj).



15

Foto © Copyright: Universiteti Poljs

Ç' janë prioritetet kombëtare dhe rajonale ?

Projektet për “Rritjen e kapaciteteve” duhet të bazohen në prioritetet rajonale ose kombëtare. Këto të fundit përcaktohen nga Ministria e Arsimit dhe Sportit. Aktualisht, disa nga këto prioritetet janë trajnimi dhe formimi i mësuesve, shkencat sociale, administrim biznesi, shkencat inxhinierike (tekstile, ushqimore, etj), shkencat kompjuterike, bujqësia, shërbimet sociale. Prioritet tjetër përbën qeverisja dhe menaxhimi i IAL-ve, krijimi dhe përmirësimi i shërbimeve të studentëve si qendrat e karrierës, bibliotekat, sigurimi i cilësisë, zhvillimi i programeve profesionale post sekondare, bashkëpunimi i universiteteve me biznesin, etj. Prioritetet kombëtare dhe rajonale mund të përditësohen pas publikimit të Thirrjes së re.

Ç' mbulon granti Erasmus+ për CBHE?

Granti Erasmus+ mbulon kostot për pagesat e stafit, udhëtimet dhe akomodimet për aktivitetet e parashikuara në projekt, kostot për pajisje të reja dhe shërbime të tjera, siç parashikohen në *Udhëzuesin e programit Erasmus+*. Buxheti llogaritet me kosto për njësi për tre zërat e parë, me përjashtim të pajisjeve që llogariten me koston reale.

Si bëhet aplikimi i projekteve dhe vlerësimi ?

Aplikimi bëhet online brenda afatit të përcaktuar nga Agjencia Ekzekutive. Vlerësimi i projekt propozimeve bëhet nga ekspertë të pavarur që rekrutohen nga Agjencia Ekzekutive në Bruksel.

Për më tepër informacion dhe mbështetje vizitoni:

Programme Guide Version 1(2015): 01/10/2014

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/documents/erasmus-plus-programme-guide_en.pdf

faqe 146-165; faqe 287-29

Zyra Kombëtare Erasmus+

<http://erasmusplus.al>

EACEA

http://eacea.ec.europa.eu/erasmus-plus_en

PROGRAMI JEAN MONNET

Ky program mbështet dhe promovon thellimin e njohurive rreth çështjeve të Integritit Evropian, mësimdhënien dhe kërkimin mbi historinë, politikën, ekonominë, marrëdhëniet ndërkombëtare dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian. Aplikimi në programin Jean Monnet është i hapur për të gjithë Institucionet e Arsimit të Lartë dhe për të gjitha disiplinat që kanë pikë-prerje me fushën e Integritit Evropian.

Ky aplikim ka një procedurë të thjeshtë dhe bëhet në bazë institucioni. Ai nuk kërkon detyrimisht krijimin e partneriteve me IAL –të tjera.

Në Jean Monnet aplikohet për:

Mësimdhënie dhe kërkim

- ✓ Modulet Jean Monnet (Kurse afatshkurtra në fushën e Integritit Evropian me një minimum prej 40 orësh mësimi për një vit akademik);
- ✓ Poste Lektorësh Jean Monnet (Poste lektorësh të specializuar në fushën e studimeve të Integritit Evropian me një minimum prej 90 orësh mësimi për një vit akademik);
- ✓ Qendrat e Ekselencës Jean Monnet (Ngritja e qendrave për njohuri dhe burime akademike mbi disiplinat e BE-së, nën udhëheqjen e një katedre ekzistuese Jean Monnet);

Debate dhe shkëmbime

- ✓ Rrjetet Jean Monnet (Aktivitete për zgjerimin e bashkëpunimit, mbledhjen e informacionit dhe ndarjen e praktikave më të mira, sistemimi i njohurive dhe nxitja e rezultateve të kërkimit në shkallën më të lartë nëpërmjet një rrjeti të krijuar nga institucioni aplikant);
- ✓ Projekte Jean Monnet (Aktivitete promovimi për problematikat e Integritit Evropian, programe trajnimi);

Mbështetje për Institucionet dhe Shoqatat

- ✓ Mbështetje për Institucionet që analizojnë dhe shpërndajnë njohuri rreth BE-së;
- ✓ Mbështetje për Shoqatat e profesorëve dhe kërkuesve të specializuar në studimet evropiane;

Një informacion më i plotë për aplikimet Jean Monnet ndodhet në faqen në vijim:

http://eurlex.europa.eu/legalcontent/EN/TXT/?uri=uriserv:OJ.C_.2014.344.01.0015.01.ENG

Për më shumë informacion për programin Jean Monnet si dhe për 'Udhëzuesin e aplikimit', mund të vizitoni:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/discover/guide/index_en.htm



PROGRAMET E TJERA NË KA2

Aleancat e Njohurive

Aleancat e Njohurive janë projekte ndërkombëtare bashkëpunimi kryesisht midis institucioneve të arsimit të lartë dhe bizneseve. Aleancat e njohurive janë të hapura për çdo disiplinë, fushë apo bashkëpunim ndër-sektorial.

Aleancat në Fushën e Aftësive

Aleancat në Fushën e Aftësive synojnë të përmirësojnë aftësitë e individëve dhe të sigurojnë përputhje midis arsimit fillestar dhe të vazhduar profesional me nevojat specifike/sectoriale të tregut të punës dhe kërkesat për aftësi të reja për një ose më shumë profile punësimi.

Partneritetet Strategjike në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë

Partneritetet strategjike në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë u japin mundësinë organizatave aktive në këto fusha, ndërmarrjeve, institucioneve publike, agjencive, etj të bashkëpunojnë për zbatimin e praktikave novatore në mësimdhënie, trajnim, mësimnxënie, punë rinore, modernizim institucional dhe inovacion shoqëror.

Si rregull, “Aleancat e njohurive”, “Aleancat në fushën e aftësive” dhe “Partneritetet strategjike në fushën e arsimit, trajnimit dhe rinisë” përfshijnë bashkëpunimin ndërmjet institucioneve dhe organizatave të ngritura në Vendet e Programit.

Megjithatë, organizatat dhe institucionet nga vendet partnere si Shqipëria mund të përfshihen në këto bashkëpunime si partnerë (jo si aplikant), vetëm nëse pjesëmarrja e tyre ka një vlerë të shtuar në projekt.



Pjesa 2

KU APLIKOJNË INDIVIDËT SHQIPTARË (STUDENTË, PEDAGOGË, STAF ADMINISTRATIV) NË ERASMUS+?



KA1 "SHKËMBIMET AFATSHKURTRA PËR STAFET DHE STUDENTËT" (INTERNATIONAL CREDIT MOBILITY)

Nëse universiteti ku studioni ose punoni është përzgjedhur fitues në një projekt dypalësh në kuadër të komponentit *International Credit Mobility*, studentët, pedagogët, stafi administrativ mund të aplikojnë për shkëmbime afatshkurtra, përkatësisht nga 3 deri në 12 muaj për studentët në Bachelor, Master, PhD dhe 5 ditë deri në 2 muaj për stafet akademike dhe administrative. Kriteret gjuhësore (gjuha dhe niveli i kërkuar) janë përcaktuar në marrëveshjen ndër-institucionale midis dy universiteteve.

SIVEPRON STUDENTI /STAFI?

Individët duhet të kontaktojnë zyrat e marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve pranë universitetit për të mësuar nëse ekziston një projekt shkëmbimesh Erasmus+. Ata duhet të informohen për hapjen e aplikimeve individuale, kriteret e përzgjedhjes, afatet e aplikimit, etj.

Një student duhet të dijë që:

Kriteret e përzgjedhjes për studentët dhe stafet negocohen midis institucionit dërgues dhe atij pritës. Ato duhen bërë publike me hapjen e aplikimeve dhe të shpërndahen në një shkallë sa më të gjerë.

Njohja e periudhës së studimit është kusht i detyruar midis institucionit pritës dhe atij dërgues. Institucioni pritës është i detyruar të pajisë studentin dhe institucionin dërgues me listën e notave. Institucioni dërgues duhet të njohë plotësisht modulet që studenti ka kryer gjatë shkëmbimit dhe t'ia regjistrojë ato në listën e notave. Për këtë arsye, studenti plotëson "Marrëveshjen për kryerjen e studimeve (*Learning Agreement for studies*)" (shih linkun: http://erasmusplus.al/sq/?page_id=1068)

Marrëveshja për kryerjen e studimeve plotësohet nga studenti para mobilitetit, bazuar në modulet që ai zgjedh të kryejë në universitetin pritës (tabela A). Këto module janë paraqitur në katalogun e vënë në dispozicion nga universiteti pritës. Gjithashtu studenti plotëson tabelën B me modulet përkuese në universitetin dërgues, të cilat do t'i njihen pas periudhës së shkëmbimit.

Marrëveshja nënshkruhet nga studenti, personi përgjegjës në universitetin dërgues dhe personi përgjegjës në universitetin pritës.

STAFI

Stafi (akademik ose administrativ) në varësi të qëllimit të shkëmbimit plotëson:
Marrëveshjen e shkëmbimit për mësimdhënie (*Staff mobility for teaching agreement*) (shih linkun: http://erasmusplus.al/sq/?page_id=1068)
Marrëveshjen e shkëmbimit për trajnim (*Staff mobility for Training agreement*) (shih linkun: http://erasmusplus.al/sq/?page_id=1068)

Ç'është Marrëveshja e pjesëmarrjes (*The participant grant agreement*)?

Përveç marrëveshjeve të mësipërme, studentët dhe stafet nënshkruajnë gjithashtu edhe "Marrëveshjen e pjesëmarrjes" (*The participant grant agreement*), e cila përcakton kushtet e mbështetjes financiare dhe modalitetet e pagesës. **Ky dokument nënshkruhet midis individit dhe institucionit në Vendin e Programit para fillimit të shkëmbimit.**

Për më tepër informacion, duhet të kontaktoni zyrat e marrëdhënieve me jashtë dhe projekteve pranë universitetit tuaj.

KA 1 SHKËMBIMET PËR MASTERA DHE DOKTORATA TË PËRBASHKËTA (DEGREE MOBILITY) NË ERASMUS MUNDUS DHE ERASMUS+

Aplikimet për master apo doktoratë

Ky komponent mundëson kryerjen e një programi master apo doktorate, vetëm me kohë të plotë, në dy ose më shumë universitete evropiane me bursë Erasmus+. Një kusht i domosdoshëm për të aplikuar është njohja e gjuhës angleze dhe mbrojtja me një nga testet e njohura në rang ndërkombëtar si TOEFL ose IELTS-i. Diploma që lëshohet në fund të studimeve është diplomë e përbashkët që njihet nga të gjitha universitetet evropiane. Aplikimet për Master ose PhD zakonisht hapen në muajin tetor dhe qëndrojnë të hapura deri në muajin dhjetor të çdo viti. Në disa raste, mund të kenë afat deri në muajin janar të vitit pasardhës.

Bursat Erasmus+ mbulojnë të gjitha shpenzimet, përfshirë transportin, qëndrimin, pagesën e regjistrimit, sigurimin e jetës, kostot e vizës, etj.

Vini re

Aplikimet për PhD do të jenë të mundura deri në vitin 2017. Krahas Erasmus+, aplikimet për doktoratë, post doktoratë ose grante për kërkim shkencor do të mundësohen nëpërmjet komponentit Maria Sklodowska Curie, të programit 'Horizon 2020 Framework Programme for Research and Innovation'.

Për më tepër informacion, vizitoni linkun: <http://ec.europa.eu/research/mariecurieactions/>

Si bëhet aplikimi?

-Si fillim, brenda listës së masterave dhe doktoratave të ofruara, identifikoni ato programe që përshtaten më tepër me studimet që keni kryer ose që janë të një fushe të përafërt. Lista e plotë e masterave dhe PhD-ve ndodhet në linqet në vijim:

Lista e plotë e Master-ave të përbashkët Erasmus Mundus: http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/results_compendia/selected_projects_action_1_master_courses_en.php

Lista e plotë e Doktoratave të përbashkëta Erasmus Mundus : http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/results_compendia/selected_projects_action_1_joint_doctorates_en.php

-Shqyrtoni informacionin e dhënë tek faqja e internetit e masterit/doktoratës që keni zgjedhur. Shikoni me vëmendje udhëzimet për aplikimin, kriteret, afatin e fundit, kërkesat gjuhësore dhe dokumentet e tjera që mund të nevojiten për dosjen e aplikimit. Çdo master/doktoratë ka kriteret dhe afate specifike.

-Dokumentet që kërkohen përgjithësisht përfshijnë: një letër motivimi; diplomën dhe listën e notave; dëshminë e gjuhës angleze të mbrojtur me IELTS ose TOEFL, dy letra rekomandimi, dokumentin e identifikimit. Në rastin e PhD, mund të kërkohet një përshkrim i shkurtër i projektit shkencor që do të bëni.

Në faqen e internetit të çdo Master-i ose Doktorate do të merrni informacion më të detajuar për kriterin gjuhësor, numrin e pikëve të kërkuara, rastet kur studimet e mëparshme janë kryer në këtë gjuhë etj.

-Sigurohuni që dokumentet e kërkuara të jenë të përkthyer në Anglisht dhe të noterizuara (në rast se nuk parashikohet në gjuhë tjetër).

-Aplikimi juaj bëhet **VETËM** online nëpërmjet website-it të masterit/doktoratës.

*Mund të aplikoni paralelisht, në 3 programe të ndryshme studimi, brenda të njëjtit nivel (dmth 3 Master-a ose 3 Doktorata të ndryshme.) Nëse jeni fitues në 2 prej tyre, do të ndiqni vetëm njërin.

-Tregoni kujdes të respektoni afatin e fundit të aplikimit, pasi asnjë aplikim nuk do të jetë i vlefshëm po kaloi afati.



Një student/staf shqiptar mund të aplikojë gjithashtu për shkëmbime afatshkurtra nëpërmjet:

Programeve të shkëmbimeve afatshkurtra (Partneritetet Erasmus Mundus, grupimi 2)

Këto programe (shihni linkun http://eacea.ec.europa.eu/erasmus_mundus/results_compendia/selected_projects_action_2_en.php) i ofrojnë çdo student, pedagogu apo të punësuar në institucionet e arsimit të lartë mundësinë e shkëmbimeve akademike afatshkurtra në një mori universitetesh evropiane. Aktualisht, kjo mundësi përfitohet duke aplikuar në një nga katër partneritetet Erasmus Mundus për një periudhë shkëmbimi. Për shkëmbimet akademike në nivelin bachelor, lejohen të aplikojnë vetëm studentët e universiteteve shqiptare partnere brenda secilit program (shih më poshtë). Për shkëmbimet akademike në nivelin Master, PHD, Post-doc lejohen të aplikojnë në kategorinë T2 edhe studentët e universiteteve shqiptare që nuk janë partnere brenda secilit partneritet. Kushti i vetëm është që studentit të jetë i regjistruar në këto nivele pranë një universiteti shqiptar në momentin e aplikimit.

APLIKIMET INDIVIDUALE PËR SHKËMBIMET AFATSHKURTRA NË PARTNERITETET ERASMUS MUNDUS



Foto © Copyright: Universiteti i Tiranës

Partneriteti 1: TECH-WB

Partnerët shqiptarë: Universiteti “Fan Noli” Korçë, Universiteti Bujqësor i Tiranës, Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës, Universiteti “Eqrem Çabej” i Gjirokastrës, Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës.

Kohëzgjatje e shkëmbimit:

- Bachelor : I semestër deri në 1 vit akademik;
- Master : I semestër deri në 2 vite akademikë;
- PhD : 6 muaj deri në 34 muaj;
- Postdoc : 6 muaj deri në 10 muaj;
- Staf administrativ I muaj;

Disiplinat kryesore akademike në TECH-WB: teknologjitë e informacionit dhe komunikimit, inxhinieria dhe energjetika, mbrojtja e mjedisit, bujqësia, minierat, drejtësia, administrim biznesi, administrimi publik, marrëdhënie ndërkombëtare, turizmi dhe trashëgimia kulturore, gjuhët e huaja.

Link: <http://green-tech-wb.uvigo.es/>

Partneriteti 2: SUNBEAM

Partnerët shqiptarë: Universiteti Bujqësor i Tiranës dhe Universiteti “Aleksandër Moisiu” i Elbasanit.

Kohëzgjatje e shkëmbimit:

- Bachelor : I semestër deri në 10 muaj;
- Master : I semestër deri në 2 vite akademikë;
- PhD : 6 deri në 36 muaj;
- Postdoc : 6 deri në 10 muaj;
- Staf akademik dhe administrativ: 1-3 muaj;

Disiplinat kryesore akademike: shkencat bujqësore, arkitektura dhe planifikimi hapësinor, art dhe dizajn, biznes dhe menaxhim, gjeologji dhe gjeografi, shkenca humane, gjuhësi, drejtësi, informatike dhe matematike, shkenca natyrore, shkenca shoqërore, teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.

Link: <http://www.sunbeam.univpm.it/>

Partneriteti 3: EUROWEB

Partnerët shqiptarë: Universiteti “Luigj Gurakuqi” i Shkodrës.

Kohëzgjatje e shkëmbimit:

- Bachelor : 10 muaj;
- Master : 10 ose 20 muaj;
- PhD : 18 deri në 34 muaj;
- Postdoc: 10 muaj;
- Stafi akademik dhe administrative: 3 muaj;

Disiplinat kryesore akademike: inovacioni, inxhinieria elektrike dhe kompjuterike, inxhinieria financiare dhe shkencat mjedisore

Link: <http://www.mrtc.mdh.se/euroweb/index.php>

Partneriteti 4: SIGMA

Partnerët shqiptarë: Universiteti “Aleksandër Moisiu” i Elbasanit, Universiteti “Ismail Qemali” i Vlorës, Universiteti Evropian i Tiranës;

Kohëzgjatje e shkëmbimit:


- Bachelor : 5 deri në 10 muaj;
- Master : 5 deri në 22 muaj;
- PhD : 5 deri në 34 muaj;
- Postdoc: 6 muaj;
- Stafi akademik dhe administrative: 1 muaj;

Disiplinat kryesore akademike: shkencat bujqësore, arkitektura dhe planifikimi hapësinor, art dhe dizajn, biznes dhe menaxhim, gjeologji dhe gjeografi, shkenca humane, gjuhësi, drejtësi, informatike dhe matematike, shkenca natyrore, shkenca shoqërore, shkenca komunikimi dhe teknologjitë e informacionit dhe komunikimit.

Link: <https://portal.uw.edu.pl/web/sigma/about-sigma>

Kushtet bazë të aplikimit:

- studenti duhet të jetë i regjistruar pranë një universiteti shqiptar në momentin e aplikimit;
- studenti duhet të kthehet dhe diplomohet pranë universitetit shqiptar pas kryerjes së periudhës së shkëmbimit;
- studenti nuk duhet të ketë ndjekur studimet apo jetuar për një periudhë 12 mujore gjatë 5 viteve të fundit në një nga shtetet e BE-së;





- Studenti duhet të ketë mbaruar të paktën I vit të plotë akademik (60 ECTS) në momentin e aplikimit në Bachelor,
- Studenti duhet të ketë njohjen dhe mbrojtjen e gjuhës së universitetit ku do të kryhet shkëmbimi. Provimi dhe niveli i kërkuar ndryshojnë sipas universitetit pritës.
- Aplikimet për këtë komponent, përgjithësisht qëndrojnë të hapura gjatë periudhës Nëntor-Mars të çdo viti.



KA 2 KOMPONENTI I MOBILITETEVE NË KUADËR TË PROJEKTEVE "RRITJA E KAPACITETEVE NË ARSIMIN E LARTË"

Projektet për "Rritjen e kapaciteteve" përmbajnë edhe një komponent shkëmbimesh për Shqipërinë. Nëse universiteti juaj ka fituar një projekt për "Rritjen e kapaciteteve" që përmban komponent shkëmbimesh, studentëve dhe stafit ju lind e drejta për:


- shkëmbime nga 3-12 muaj për çdo cikël studimi për studentët;
- praktika profesionale në kompani dhe biznese nga 2-12 muaj (duke filluar nga viti 2016) për studentët.
- shkëmbime nga 5 ditë deri në 2 muaj për stafet akademike dhe administrative.

Këto shkëmbime kryhen në përputhje me rregullat e shpjeguara më sipër për KA1 "International credit mobility";

KEY ACTION 3 “MBËSHTETJA E REFORMAVE ARSIMORE”

Për sa i përket këtij komponenti, ai përfshin mbështetjen për reformat e politikave arsimore nëpërmjet ‘metodës së hapur të koordinimit’, duke nxitur transparencën brenda BE-së dhe vendosjen e dialogut politik me shtetet jashtë saj.

Aktivitetet e këtij komponenti, kryesisht, iniciohen dhe koordinohen, nga DG EAC (Komisioni Evropian) në Bruksel në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit përkatëse.





RINIA DHE SPORTI

Shqipëria gjithashtu, përfiton në mënyrë të kufizuar nga disa komponentë të tjerë të Erasmus+ për Rininë dhe Sportin. Aktualisht, Zyra Kombëtare Erasmus+ nuk i mbulon këto komponentë, por vetëm arsimin e lartë. Për projektet në fushën e Rinisë, kontaktoni njësinë përgjegjëse “Përtej barrierave” në Link: <http://www.beyondbarriers.org/>

FJALORTH

Vendet e Programit janë vendet e BE-së plus Turqia, Islanda, Liechtensteini, Norvegjia dhe FYROM-i. (Faqe 24 në Udhëzuesin e Programit Erasmus+);

Vendet Partnere janë pjesa tjetër e botës, lista e plotë e të cilave ndodhet në linkun në vijim në faqet 24, 25:

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/documents/erasmus-plus-programme-guide_en.pdf

EACEA, Agjencia Ekzekutive për Arsimin, Mediat dhe Kulturën;

DG EAC Drejtoria e përgjithshme për Arsimin dhe Kulturën;

Udhëzuesi i programit Erasmus+ ndodhet në linkun në vijim

http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/documents/erasmus-plus-programme-guide_en.pdf

PIC është *Participant Identification Code*. Për të ditur se cili është kodi PIC i validuar i institucionit tuaj, vizitoni linkun në vijim. <http://ec.europa.eu/education/participants/portal/desktop/en/organisations/search.html>





**Për më tepër informacion vizitoni
Guidën e programit Erasmus +**

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/documents/
erasmus-plus-programme-guide_en.pdf](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/documents/erasmus-plus-programme-guide_en.pdf)

EACEA

http://eacea.ec.europa.eu/erasmus-plus_en

Zyra Kombëtare Erasmus+

<http://erasmusplus.al>

Në Facebook

Albanian Erasmus + Office